

Data: 11.09.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pjese këmbimi, goma dhe bateri”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)

34330000-9 - Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash

VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 12 356 272 (dymbëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar"

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur", mbi kufirin e lartë monetar edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (a) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe / ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 39% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e

operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuar (ku të provohet lidhja me prodhuesin) se është i autorizuar të tregtojë mallrat objekt prokurimi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet e përcaktuara. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës dhe furnizimin e mallrave sipas grafikut të lëvrimin, deri në ezaurimin e sasive sipas kërkesave të autoriteteve kontraktore përfituese.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë mbi garancinë, në përputhje me specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit, ku të përcaktohet se të gjitha produktet e ofruara, përfshirë gomat, bateritë si dhe pjesët e këmbimit (filtra dhe çepa frenimi), do të kenë një garanci jo më pak se 6 (gjashtë) muaj nga data e dorëzimit dhe pranimit të tyre nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik është i detyruar të kryejë zëvendësimin pa asnjë kosto shtesë të çdo produkti që paraqet defekt për shkak të prodhimit, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar (në rastin konkret gomat) është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të difekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre. Përcaktimi i garancisë për goma në përdorim për mjete pune. Per fadroma dhe kamiona etj., për jo më pak se 6 muaj është një tregues i bazuar dhe vlerësohet në proporcion me objektin, fondin limit të lotit përkatës, duke u referuar edhe në kohëzgjatjen kontrates, si dhe vlerësohet i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **katalogë / broshurë / skedë teknike** të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik

duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit. Dokumenti duhet të jete në gjuhen shqipe.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve /broshurës/ skedës teknike është një kërkesë proporcionale dhe ngushtësisht e lidhur me objektin e prokurimit pasi i jep mundësinë organit qendror blerës për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoritetet Kontraktore përfutuese për llogari të të cilëve Organi Qëndror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjendet mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambjent, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e zëvendësimit të gomave.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontratës.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Neneve: Neni 41, pika 4/ç, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion 1 (një) ambjent ekzekutimin e punës objekt prokurimi.

Ky kriter është vendosur në mënyrë që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme organizative, për të zbatuar dhe për të përmbushur kontratën në përputhje me specifikimet dhe standardet e kërkuara nga Autoriteti kontraktor dhe nisur nga shumëllojshmëria e mjeteve dhe specifikat e veçanta të tyre.

Bazuar në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar. Ambientet e ushtrimit të aktivitetit në pronësi ose me qera të jenë të pasqyruara në Ekstraktin e QKB-së.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues, si dhe vendosjen e gomave pranë ambienteve të tij, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoritetet Kontraktore përfituese.

Në përputhje me këto dispozita, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë **dokumentacion plotësues** që dëshmon se operatori ekonomik është në gjendje të realizojë kontratën, duke përfshirë **aspekte logjistike dhe operacionale**, siç është **transporti dhe dorëzimi i mallrave në vendin e përcaktuar**. Ky kriter është **proporcional dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës**, dhe siguron që **furnizimi të realizohet në përputhje me kushtet teknike dhe vendndodhjet e specifikuara nga autoriteti kontraktor**.

2.3.8 Operatori ekonomik, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor nga 1 (një) copë mostër për secilin nga artikujt objekt prokurimi, konkretisht:

- Goma 23.5/70-16

- Goma 7.50-16
- Goma 8.25-16

Mostrat duhet të jenë në përputhje me produktet e deklaruar në ofertën teknike, katalogë/broshura/skeda teknike, si dhe me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Mostrat do të paraqiten në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor dhe do të administrohen me procesverbal, në përputhje me Udhëzimin e APP-së nr. 03, datë 12.04.2022, “Për administrimin e mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.

Mosparaqitja e mostrave, paraqitja e mostrave që nuk përputhen me produktet e deklaruar në dokumentacionin teknik, ose mospërputhja e tyre me specifikimet teknike të kërkuara, përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Argumentimi: 2.3.8 Operatori ekonomik, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor nga 1 (një) copë mostër për secilin nga artikujt objekt prokurimi, konkretisht:

- Goma 23.5/70-16
- Goma 7.50-16
- Goma 8.25-16

Mostrat duhet të jenë në përputhje me produktet e deklaruar në ofertën teknike, katalogë/broshura/skeda teknike, si dhe me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Mostrat do të paraqiten në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor dhe do të administrohen me procesverbal, në përputhje me Udhëzimin e APP-së nr. 03, datë 12.04.2022, “Për administrimin e mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.

Mosparaqitja e mostrave, paraqitja e mostrave që nuk përputhen me produktet e deklaruar në dokumentacionin teknik, ose mospërputhja e tyre me specifikimet teknike të kërkuara, përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 40, pika 6, shkronja “a”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, lidhur me paraqitjen e mostrave të mallrave objekt prokurimi, si dhe të Udhëzimit të APP-së nr. 03, datë 12.04.2022, “Për administrimin e mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.*

Kërkesa për paraqitjen e mostrave për gomat me dimensione 23.5/70-16, 7.50-16 dhe 8.25-16 është e nevojshme për verifikimin fizik të artikujve të ofruar, duke marrë parasysh rëndësinë që kanë gomat për sigurinë, lëvizjen dhe funksionimin e mjeteve ku do të montohen. Përputhshmëria e tyre me kërkesat teknike është e nevojshme për përdorimin e mjeteve sipas destinacionit dhe kushteve të punës.

Nëpërmjet mostrave, Autoriteti Kontraktor ka mundësi të verifikojë drejtpërdrejt markën dhe modelin e gomës, dimensionin e stampuar, profilin e shkeljes, shënimet teknike dhe identifikuese, kodin e datës së prodhimit, si dhe gjendjen fizike të produktit, përfshirë mungesën e dëmtimeve të dukshme, çarjeve, deformimeve dhe shenjave të përdorimit. Verifikimi do të kryhet vetëm për elementet e kërkuara në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit.

Paraqitja e nga një mostre për secilin prej tri dimensioneve mundëson kontrollin e veçantë të secilit artikull, pasi mostra e një dimensionit nuk provon përputhshmërinë e gomave të dimensioneve të tjera. Për secilën mostër do të verifikohet nëse produkti fizik përputhet me markën, modelin dhe karakteristikat e deklaruara në ofertën teknike, katalogë, broshura apo skeda teknike.

Kontrolli fizik plotëson verifikimin dokumentar, duke mundësuar identifikimin e mospërputhjeve ndërmjet artikullit të paraqitur dhe dokumentacionit të ofertës. Karakteristikat që nuk mund të vërtetohen nëpërmjet kontrollit pamor, si performanca dhe rezistenca në përdorim, do të vlerësohen nëpërmjet dokumentacionit provues të kërkuar në dokumentet e tenderit.

*Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe kufizohet në **nga 1 (një) copë mostër për secilin nga tri dimensionet e përcaktuara**, duke mundësuar verifikimin e tyre pa kërkuar sasi të panevojshme mostrash. Vlerësimi do të mbështetet vetëm në specifikimet teknike të shpallura dhe do të kryhet sipas të njëjtave kërkesa për të gjithë operatorët ekonomikë, pa përdorur elemente subjektive apo kritere të paparashikuara në dokumentet e tenderit.*

Mostrat do të administrohen me procesverbal, në përputhje me Udhëzimin e APP-së nr. 03, datë 12.04.2022. Në procesverbal do të dokumentohen identifikimi i mostrave të paraqitura dhe rezultatet e verifikimit të përputhshmërisë së tyre me dokumentacionin teknik të ofertës dhe specifikimet teknike të kërkuara.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë që gomat e ofruara përputhen fizikisht me produktet e deklaruara dhe me kërkesat e dokumenteve të tenderit, në funksion të furnizimit të artikujve të përshtatshëm për mjetet përkatëse dhe përmbushjes së kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Objekti: “Blerje pjesë këmbimi, goma, dhe bateri”

Specifikimet teknike janë përcaktuar në mbështetje të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021,

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, me qëllim përcaktimin e karakteristikave të nevojshme që mallrat të përmbushin funksionin për të cilin prokurohen.

Kërkesat teknike lidhen me nevojën për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e gatishmërisë së mjeteve dhe makinerive të Autoritetit Kontraktor. Furnizimi me artikuj të përshtatshëm synon të parandalojë defektet që shkaktohen nga përdorimi i pjesëve të papërputhshme, të kufizojë ndërprerjet e punës dhe të mundësojë përdorimin e sigurt të mjeteve.

1. Argumentimi i specifikimeve teknike të gomave

Përcaktimi i dimensioneve, strukturës radiale ose diagonale, tipit me ose pa dhomë ajri dhe përputhshmërisë me diskun e rrotës lidhet me karakteristikat konstruktive të mjeteve ku gomat do të montohen. Këto kërkesa mundësojnë montimin e përshtatshëm dhe shmangin përdorimin e gomave që nuk përputhen me konfigurimin teknik të mjetit.

Indekset e ngarkesës dhe shpejtësisë, vlerësimi PR dhe parametrat e presionit të fryrjes shërbejnë për përzgjedhjen e gomave që përballojnë ngarkesat dhe regjimin e punës së mjeteve. Parametrat për përdorim me rrota teke ose dyshe duhet të përputhen me konfigurimin përkatës të montimit.

Kërkesat për profilin dhe thellësinë e shkëljes lidhen me kushtet e përdorimit, nevojën për tërheqje dhe rezistencën ndaj konsumimit. Për gomat e makinerive të punës, përfshirë dimensionet **23.5/70-16, 7.50-16 dhe 8.25-16**, përzgjedhja duhet të mbështetet në kërkesat e makinerisë përkatëse dhe kushtet e terrenit ku ajo punon.

Kërkesa që gomat të jenë të reja dhe të pariveshura synon furnizimin me produkte pa konsumim të mëparshëm. Kufizimi i periudhës nga prodhimi në jo më shumë se gjashtë muaj synon të kufizojë furnizimin nga stoke të vjetra; ky afat përbën kërkesë të Autoritetit Kontraktor dhe nuk zëvendëson kontrollin e kushteve të ruajtjes dhe të gjendjes fizike të gomave.

Stampimet për prodhuesin, dimensionin, strukturën, tipin, indeksin e ngarkesës dhe shpejtësisë, datën e prodhimit dhe homologimin përkatës mundësojnë identifikimin dhe gjurmueshmërinë e produktit, si dhe krahasimin me dokumentacionin teknik të ofertës.

Kërkesa për goma të të njëjtit tip prodhimi brenda të njëjtit dimension synon njëtrajtshmërinë e furnizimit, veçanërisht për gomat që përdoren në të njëjtin aks. Montimi, balancimi dhe shërbimi i konvergjencës, sipas zbatueshmërisë për mjetin, synojnë vendosjen e rregullt në përdorim dhe kufizimin e konsumimit të parregullt.

2. Argumentimi i specifikimeve teknike të baterive

Kapacitetet **100 Ah, 180 Ah dhe 230 Ah** lidhen me nevojat e sistemeve elektrike dhe të ndezjes së mjeteve përkatëse. Përzgjedhja duhet të sigurojë përputhshmëri edhe me tensionin, përmasat, vendosjen e poleve dhe sistemin e karikimit të mjetit.

Kërkesa për prodhim jo më herët se gjashtë muaj nga dita e furnizimit synon të kufizojë periudhën e qëndrimit në magazinë përpara dorëzimit. Etiketimi me të dhënat teknike dhe kodin identifikues mundëson kontrollin e kapacitetit të deklaruar dhe gjurmueshmërinë e baterisë.

Përputhja e pozicionit të poleve është e nevojshme për lidhjen e saktë me instalimin ekzistues, pa ndërhyrje të papërshtatshme në kabllot e mjetit. Ambalazhimi mbrojtës synon shmangien e dëmtimeve të trupit dhe terminaleve gjatë transportit dhe magazinimit.

3. Argumentimi i specifikimeve teknike të filtrave dhe parafiltrave

Përcaktimi i filtrave sipas markës, modelit, motorizimit dhe numrit të shasisë shërben për identifikimin e artikullit të përshtatshëm për çdo mjet. Përmasat, lidhjet dhe parametrat funksionalë duhet të mundësojnë montimin pa modifikime dhe funksionimin sipas kërkesave të prodhuesit të mjetit.

Kërkesat për shkallën e filtrimit, prurjen dhe rezistencën gjatë punës synojnë mbrojtjen e motorit dhe të sistemeve përkatëse nga papastërtitë, duke ruajtur furnizimin e nevojshëm me vaj, karburant ose ajër. Parafiltrat shërbejnë për filtrimin paraprak dhe, kur parashikohet nga sistemi, për ndarjen e ujit nga karburanti.

Kërkesa për produkte të reja, të përdorura dhe në ambalazh mbrojtës synon shmangien e ndotjes ose dëmtimit përpara montimit. Kodi identifikues dhe dokumentacioni i prodhuesit mundësojnë verifikimin e përputhshmërisë me mjetin.

4. Argumentimi i specifikimeve teknike të cepave dhe tamburove të frenimit

Kërkesat për pjesë të reja, pa çarje, deformime apo dëmtime lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e sistemit të frenimit. Përputhja me markën, tipin dhe shasinë e mjetit, si dhe respektimi i përmasave dhe tolerancave të prodhuesit, synojnë montimin e saktë dhe funksionimin e rregullt të pjesëve.

Materiali i fërkimit duhet të jetë i përshtatshëm për ngarkesën dhe temperaturat e punës. Kërkesa për mungesë azbesti synon mbrojtjen e shëndetit gjatë përdorimit dhe mirëmbajtjes. Sipërfaqet e rregullta të tamburove dhe mungesa e defekteve janë të nevojshme për kontaktin e përshtatshëm me elementet e fërkimit.

Referenca ndaj Rregullores UN/ECE nr. 90, ose ekuivalente, zbatohet për pjesët që përfshihen në fushën e saj të zbatimit.

5. Standardet, ekuivalenca dhe garancia

Referencat ndaj standardeve shërbejnë për përcaktimin e metodave të verifikimit dhe kërkesave teknike sipas llojit të artikullit. Ato duhet të zbatohen brenda fushës përkatëse dhe të shoqërohen me pranimin e ekuivalentëve.

Markat, modelet dhe numrat e shasisë së mjeteve shërbejnë për identifikimin e pajisjeve ekzistuese. Pranimi i produkteve origjinale ose ekuivalente, me përputhshmëri të dokumentuar, mundëson konkurrencën duke ruajtur kërkesat funksionale.

Garancia gjashtëmujore synon mbulimin e defekteve që i atribuohen produktit, sipas kushteve të kontratës, dhe përgjegjësinë e furnizuesit për trajtimin e tyre.

Specifikimet teknike janë hartuar nga autoritetet kontraktore përfituese për objektin që prokurohet sipas nevojës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke u referuar në eksperiencën e mëparshme të vetë autoritetit kontraktor, në specifikimet e kontrates se fundit te suksesshme, për pjesët e këmbimit për automjete, goma dhe bateri, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT: